

GRIPIN NË SHQIPËRI PËR SEZONIN 2017-2018 JAVA 50 (11 - 17 DHJETOR)

PËRMBLEDHJE

Në këtë vëllim:

<i>Përmbledhje</i>	1
<i>Prirja e IRS dhe IRP</i>	2
<i>Frekuenca e hasjes</i>	2
<i>Nr total i mostrave</i>	3
<i>SRRA dhe ILI</i>	4
<i>Shpërndarja moshore</i>	5
<i>STRRA</i>	6
<i>STRRA moshore</i>	7
<i>IRA-pragu</i>	9
<i>Kurba epidemike</i>	11
<i>Info nga TESSY</i>	16
<i>Info mbi Vaksininim</i>	12

Informacion kyç:

- Situata në EURO-TESSY
- Përbërja e vaksinës
- STRRA
- Vaksininimi ndaj Gripit

Nga të dhënat e raportimit sipas survejancës së infeksioneve akute respiratore të sipërme dhe të poshtme të sistemit ALERT, survejancës sentinel të sëmundjeve të ngjashme me Gripin (ILI) në rrethin e Tiranës, dhe survejancës së infeksioneve respiratore akute të rënda (SRRA) në spitalet kryesore në të gjithë vendin si dhe raportimit rutinë, vërejmë se trendi i infeksioneve respiratore paraqet ritje në javën 50/2017 .

Kontinenti Europian

Në javën 50/2017 intensiteti i aktivitetit të gripit në kontinentin Europian është ende i ulët. 8 nga 45 vende nuk raportuan përhapje gjeografike, 23 vende kanë raportuar raste sporadike, 5 kanë raportuar përhapje gjeografike lokale, 6 vende (Izraeli, Holanda, Norvegjia, Portugalia, Spanja dhe Ukraina) kanë raportuar përhapje rajonale dhe 3 vende (Franca, Suedia dhe Turqia) kanë raportuar aktivitet të përhapur.

Në total 26.4% e mostrave të marra këtë javë janë konfirmuar me virusin e gripit. Që nga java 40/2017, 62% e mostrave


janë me virusin e tipit B dhe 38% e tyre me virusin e tipit A. Nga nëntipizimi i viruseve të tipit A, 56% e tyre janë të nëntipit A(H1N1) pdm09.

Të dhënat nga 19 shtete ose rajone që raportojnë në projektin EuroMOMO treguan se vdekshmëria nga të gjitha shkaqet ishte në nivele të ulëta dhe të pritshme për këtë kohë të vitit.

Përbërja e vaksinës së gripit për hemisferin verior për sezonin 2017 - 2018 është:


- A/Michigan/45/2015 (H1N1) pdm09-like virus;
- A/Hong Kong/4801/2014 (H3N2)-like virus;
- B/Brisbane/60/2008-like virus.

1. PRIRJA E INFEKSIONEVE RESPIRATORE TË SIPËRME (IRS) DHE TË POSHTËME (IRP) NË JAVËT 35 – 50 TË VITIT 2016 DHE TË VITIT 2017 (NUMRI I RASTEVE).




Në javën e 50 të vitit 2017 vërehet një trend në rritje i numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme dhe ky numër është 28% më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

2. FREKUENCA E HASJES SË “INFEKSIONEVE RESPIRATORE TË SIPËRME DHE TË POSHTËME” SIPAS RRETHEVE NË JAVËN 49 DHE 50 TË VITIT 2017. INCIDENCA (RASTE/10 000)



Vërehet rritje e numrit të rasteve të IRA ne disa rrethe te vendit

3. NUMRI TOTAL I MOSTRAVE TË ARDHURA SIPAS JAVËVE DHE REZULTATI LABORATORIK



Prej javës së 1-rë të muajit Tetor 2017 deri më datën 24 Dhjetor 2017 kanë ardhur në ISHP dhe janë testuar 147 mostra nga persona të dyshuar për grip .

Para pranimit në laborator kryhet rregullisht monitorimi i cilësisë së mostrës sipas protokolleve standarte. Të gjitha mostrat e ardhura janë testuar me metodën molekulare të Real-Time RT PCR.


Mostrat kanë rezultuar negative për viruset e gripit.


33 kampione të ardhura nga Tirana, Elbasani, Vlora dhe Korça të cilat kanë rezultuar negative për virusin e gripit janë analizuar sipas algoritmit me panelin respirator për 21 viruse. Më poshtë vëmë re se ato kanë rezultuar pozitive për viruse të ndryshëm respiratorë:

Rhinovirus -	4 kampione
Human CoV 229 -	6 kampione
Enterovirus -	3 kampione
Human Adenovirus -	1 kampion
Human RSV -	3 kampione
Human Bocavirus -	1 kampion

Gjithashtu gjatë një hetimi të organizuar në rrethin e Pogradecit u pa që shumica e virozave respiratore të shtruara si rinofaringite kishin shenja respiratore dhe diarre dhe dje u morrën mostrat përkatëse.

4. NUMRI I MOSTRAVE SRRA DHE ILI TË ARDHURA SIPAS JAVËVE DHE REZULTATI LABORATORIK




5. SHPËRNDARJA E NUMRIT TOTAL TË RASTEVE SIPAS GRUP-MOSHËS

Vërehet që 65 (44%) e mostrave i përkasin grupmoshës pediatrike 0-14 vjeç




6. SËMUNDJE E TEPËR E RËNDË RESPIRATORE AKUTE (STRRA)




Rasti klasifikohet si SRRA (Sëmundje e rëndë respiratore akute sipas përkufizimit të OBSH dhe si STRRA (Sëmundje tepër e rëndë respiratore akute) sipas klasifikimit tonë për të gjitha rastet që kanë nevojë për shtrim në repartet e terapisë intensive dhe kanë nevojë për oksigjenim.


18 (30%) prej 61 pacientëve SRRA kanë paraqitur komplikacione (STRRA)

7. SHPËRNDARJA E RASTEVE STRRA SIPAS VENDIT TË MARRJES SË MOSTRËS




8. SHPËRNDARJA E MOSTRAVE STRRA SIPAS GRUPMOSHËS

Vërehet që 9 (50%) e mostrave STRRA i përkasin grupmoshës pediatrike 0-14 vjeç

9. SHPERNDARJA E MOSTRAVE SRRA SIPAS VENDIT TË MARRJES DHE REZULTATIT LABORATORIK

Numri më i madh i mostrave ka ardhur nga Qendra Shëndetësore Nr. 2, ndjekur nga Qendra Shëndetësore Nr. 4, Spitali Rajonal Gjirokastrë dhe Elbasan.


10. KRAHASIMI I AKTIVITETIT TË “INFEKSIONEVE RESPIRATORE TË SIPËRME (IRS) DHE TË POSHTËME (IRP)” SIPAS SEZONEVE (JAVËT 40 – 20) DHE PRAGU EPIDEMIK. RASTE/100 000





Në javën 50/2017 aktiviteti i IRA paraqet:

- prirje në rritje
- aktivitet gjeografik të përhapur
- intensitet të ulët
- impakt i ulët

11. KURBA EPIDEMIKE DHE INFEKSIONET RESPIRATORE SIPAS JAVËVE (IRA RASTE/100 000)



12. INTENSITETI I GRIPIT DHE VIRUSET QË QARKULLOJNË NË RAJONIN EUROPIAN NË JAVËN 50. <http://flunewseurope.org/>



13. MBULESA VAKSINALE NË VEND PËR VAKSINIMIN KUNDËR GRIPIT

Përditësim deri më datë 24.12.2017, mbi shpërndarjen nëpër rrethe dhe administrimin e vaksinës ndaj gripit, për personelin shëndetësor dhe aplikimi në popullatën target, për sezonin 2017-2018 (java e 8-të e raportimit).

Në javën e tetë të raportimit, procesi i shpërndarjes së vaksinës ndaj gripit, për personelin shëndetësor dhe grupet e tjera të riskut të përcaktuara në Urdhërin e MSHMS, Nr.422 datë 10.10.2017, si dhe Udhëzimeve të ISHP, ka përfunduar në të gjitha DRSH/DSHP (36/36).

Sasia prej 100 000 dozash, vaksinë ndaj gripit ka ardhur në ISHP, në bazë të marrëveshjes, midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës për Vaksinin të Barabartë, Task Forcë Botërore, Inc. Nr.Prot.3717 datë, 31.08.2017.

Shpërndarja është kryer sipas planit të shpërndarjes e hartuar nga Programi Kombëtar i Vaksinit, në ISHP (**shiko Tabelën 1**).

TABELA 1. PLANI I SHPËRNDARJES

DRSH/DSHPASHR/ Institucione	Sasia e shpërndarë (në doza)
Berat	3520
Bulqizë	850
Delvinë	330
Devoll	1200
Dibë r	1600
Durrës	6300
Elbasan	5300
Fier	6900
Gramsh	700
Gjirokastrë	1200
Has	550
Kavajë	2000
Kolonjë	550
Korçë	5600
Krujë	1800
Kuçovë	820
Kukës	1380
Kurbin	1500
Lezhë	2450
Librazhd	1800
Lushnjë	3300
M. Madhe	950
Mallakastër	850
Mat	1100
Mirditë	1010
Peqin	600
Përmet	580
Pogradec	3300
Pukë	750
QUS Shefqet Ndroqi**	100
Sarandë	1600
Skrapar	520
Shkodër	6700
Tepelenë	570
Tiranë (q.shëndet.)*	25000
Tropojë	400
Vlorë	5250
ISHP	176
QSUT Nenë Tereza**	333
Mt.Mb.Geraldinë**	171
Mt.Koco Gliozheni**	150
QSU i Traumës**	140
Forcat Ushtarake**	100

*Shënim: * ASHR Tiranë ka marrë sasi për qendrat shëndetësore.*


*** QUS “Shefqet Ndroqi”, QSUT “Nënë Tereza”, Materniteti “Mbreteresha Geraldinë”, Materniteti “Koco Glozheni”, Forcat Ushtarake dhe QSU i Traumës ka marrë sasi vaksine drejtpërdrejt nga ISHP.*

Secila DRSH/DSHP ka kryer shpërndarjen më tej në spitalet dhe qendrat shëndetësore që mbulojnë. Përfundim ka për ASHR Tiranë, që ka kryer shpërndarje vetëm në qendrat shëndetësore (duke qënë se spitalet publike të Tiranës do kontaktojnë drejtpërdrejtë me ISHP). Shpërndarja për spitalet publike të Tiranës është kryer dhe do kryhet drejtpërdrejt nga ISHP. *Spi-tali QSU i Traumës*, që ka kryer tërheqjen e vaksinës sipas kërkesave të personelit, do fillojnë aplikimin në javën në vazhdim.


Procesi i vaksinimit ndaj gripit ka filluar në 36/36 rrethe (100%), si për personelin shëndetësor ashtu edhe për grupet e tjera të riskut të rekomanduara sipas urdhërit dhe udhëzimeve të sipër përmendura.

Tek grupet e riskut, në popullatën target është aplikuar në total rreth 71% e vaksinës ndaj gripit. Grafiku i mëposhtëm paraqet mbulesën vaksinale për grupet e riskut, në popullatën target (Grafiku 1).


Grafiku 1. Mbulesa vaksinale në popullatën target



Mbulesa vaksinale në total tek personeli shëndetësor mjekësor dhe jo mjekësor në spitale është rreth 4,5%. Grafiku 2, paraqet mbulesën vaksinale për personelin shëndetësor mjekësor dhe jo mjekësor nëpër spitale.


Grafiku 2. Mbulesa vaksinale për personelin shëndetësor në spitale

Ndërsa, mbulesa vaksinale në total tek personeli shëndetësor mjekësor dhe jo mjekësor në qendrat shëndetësore dhe institucione të tjera është rreth 8,6%. Mbulesa vaksinale për këtë grup paraqitet më poshtë (Grafikun 3).

Grafiku 3. Mbulesa vaksinale për personelin shëndetësor në q.shëndetësore dhe institucione të tjera

Aktualisht në total, janë aplikuar 84 135 doza vaksinë ndaj gripit (rreth 84,1% e kësaj vaksine). Grafiku 4 paraqet ecurinë e vaksinimit ndaj gripit në të gjithë vendin, sipas shpërndajës së kryer në institucionet shtetërore.

Grafiku 4. Mbulesa vaksinale në total



Departamenti i Epidemiologjisë dhe
Kontrollit të Sëmundjeve Infektive
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

Adresa:
Rr. "A. Moisiu" Nr. 80
Tiranë

Tel: + 355 42 374 756
Fax: + 355 42 370 058
www.ishp.gov.al